



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo



Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës
Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosova
Civil Aviation Authority of Kosovo

Publikim Teknik – TP 29

Certifikata e Operatorit Ajror (COA)

Variantet/Rishikimet/Ndryshimet

Material Udhëzues (MU)

Parathënie

Hyrje

Materialet Udhëzuese (MU) kanë për qëllim t'i ndihmojnë organizatës/operatorit lidhur me çështjet administrative. Kërkesat dhe proceset administrative do të lehtësojnë ndërlidhjen me Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës (AAC). Ato duhet të konsiderohen si një mjet për organizatën/operatorin në mënyrë që të lehtësohet procesi i marrjes së miratimeve dhe autorizimeve të kërkuara dhe të përcaktuara që jepen nga Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës (AAC). Përdorimi i MU-së do të ndihmojë arritjen e pajtueshmërisë me kërkesat e AAC-së dhe do të udhëheqë përmes procesit përkatës të certifikimit ose ndryshimit në lidhje me detyrat administrative.

Qëllimi

Ky Material Udhëzues (MU) përshkruan procesin e aplikimit për variantet, rishikimet ose ndryshimet e certifikatës ekzistuese të operatorit ajror (COA). Çdo kërkesë e paraqitur në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës duhet të dërgohet **60 ditë** para datës efektive të vlerësuar. Pasi që disa nga proceset mund të konsiderohen si mjaft komplekse, ky MU synon të ofrojë udhëzime shtesë lidhur me temat e mëposhtme:

- Importimi i një aeroplani
- Eksportimi i një aeroplani
- Ndryshimet e personelit menaxhues
- Rishikimi i sistemit të manualit
- Ndryshimi i emrit të operatorit
- Ndryshimi i pronësisë së aeroplanit
- Ndryshimi i Specifikacioneve Operative të një aeroplani ose flote të aeroplanëve

Për informata të mëtejme lidhur me certifikatat e operatorëve ajrorë në Kosovë, ju lutem vizitoni faqen e AAC-së:

☞ <https://caa.rks-gov.net/wp-content/uploads/2016/05/CAA-Regulation-4-2015-on-Air-Operations-2.pdf>

Materialet dhe dokumentet relevante

Për fusha të caktuara (p.sh. disa nën-kapituj të Manualeve të Operimeve) Autoriteti i Aviacionit Civil i Republikës së Kosovës (AAC) publikon materiale udhëzuese shtesë ose kapituj shembuj (mostër). Këto dokumente ofrojnë më shumë informata lidhur me lëndët specifike.

Përveç kësaj, AAC-ja mund të publikoj edhe Udhëzime Administrative për fusha të veçanta të rregulloreve të botuara me qëllim që të qartësojë ose përkufizojë më hollësisht çështjet relevante sipas nevojës.

Nëse aplikuesi ka nevojë për informata të mëtejme, të kontaktojë në adresën më poshtë:

Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës
Lagjja Arbëria, Rruga Ahmet Krasniqi, nr. 208
10000 Prishtinë
Republika e Kosovës

E-mail: infocaa@caa-ks.org

Tel: +383 38 248 629

Fax: +383 38 211 009

Lista e Faqeve Efektive (LFE)

Kapitulli	Faqe	Rishikimi nr.	Data efektive
Parathënie	2 nga 18	Origjinal	15 maj 2019
	3 nga 18	Origjinal	15 maj 2019
Lista e faqeve efektive	4 nga 18	Origjinal	15 maj 2019
Tabela e përmbajtjes	5 nga 18	Origjinal	15 maj 2019
Shprehjet dhe shkurtesat	6 nga 18	Origjinal	15 maj 2019
	7 nga 18	Origjinal	15 maj 2019
1. Importimi i një aeroplani	8 nga 18	Origjinal	15 maj 2019
2. Eksportimi i një aeroplani	9 nga 18	Origjinal	15 maj 2019
3. Ndryshimet e personelit menaxhues	10 nga 18	Origjinal	15 maj 2019
4. Rishikimi ose nxjerrja e manualëve	11 nga 18	Origjinal	15 maj 2019
5. Ndryshimi i emrit të operatorit	12 nga 18	Origjinal	15 maj 2019
6. Ndryshimi i pronësisë	13 nga 18	Origjinal	15 maj 2019
7. Ndryshimi i Specifikacioneve Operative	14 nga 18	Origjinal	15 maj 2019
8. Kostot dhe afatet kohore	15 nga 18	Origjinal	15 maj 2019
9. Shtojcat	16 nga 18	Origjinal	15 maj 2019
<i>Shtojca 1</i>	16 nga 18	Origjinal	15 maj 2019
<i>Shtojca 2</i>	18 nga 18	Origjinal	15 maj 2019

Kontrolli i dokumentit

Emri dhe pozita		Data	Nënshkrimi
Përgatitur nga:	Kushtrim Musa Drejtore, Departamenti i Sigurisë së Fluturimeve	22 prill 2019	
Kontrolli i cilësisë nga:	Lendita Kika-Berisha Drejtoreshë, Departamenti i Cilësisë dhe Sigurisë	26 prill 2019	
Miratuar nga:	Eset Berisha Drejtore i Përgjithshëm	15 maj 2019	

Tabela e përmbajtjes

Parathënie.....	2
Lista e faqeve efektive.....	4
Tabela e përmbajtjes.....	5
Shprehjet dhe shkurtesat.....	6
Importimi i një aeroplani.....	8
Eksportimi i një aeroplani.....	9
Ndryshimet në personelin menaxhues.....	10
Rishikimi ose nxjerrja e manualëve.....	11
Ndryshimi i emrit të operatorit.....	12
Ndryshimi i pronësisë.....	13
Ndryshimi i Specifikacioneve Operative.....	14
Kostot dhe afatet kohore.....	15
Shtojcat.....	16
Shtojca 1 – Shembull i aplikacionit për pronësi të huaj	16
Shtojca 2 – Adresa të ueb-faqeve/vegëza të dobishme.....	18

Referencat ligjore dhe shkurtesat

Referencat ligjore

Referenca ligjore	Data e nxjerrjes	Lënda
Rregullorja e AAC-së nr. 03/2009 [(EU) 216/2008]	30 tetor 2009	Rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil dhe themelimi i Agjencisë Evropiane për Siguri të Aviacionit
Rregullorja e AAC-së nr. 01/2019 [(EU) 965/2012]	8 mars 2019	Kërkesat teknike dhe procedurat administrative lidhur me operacionet ajrore: ▪ Shtojca III: Pjesa-ORO (ORO.MLR.100 dhe ORO.AOC.135)
ICAO DOC 9376-AN/914 Botimi i 2-të	1997	Përgatitja e Manualit të Operimeve

Shkurtesa**Përkufizimi**

ACJ	Qendra e Qarkoreve Këshilluese
AEA	Asociacioni Evropian i Kompanive Ajrore
AFM	Manuali i Fluturimit për Avionët
AMC	Mjetet e Pranueshme të Pajtueshmërisë
COA	Certifikata e Operatorit Ajror
ARO	Kërkesat e Autoritetit për Operimet Ajrore
ATA	Asociacioni i Transportit Ajror
AACK	Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës
CL	Lista e Pajtueshmërisë
DOK	Dokument
EASA	Agjencia Evropiane e Sigurisë së Aviacionit
KE	Komisioni Evropian
ECAC	Konferenca Evropiane e Aviacionit Civil
BE	Bashkimi Evropian
FAA	Administrata Federale e Aviacionit
FOM	Manuali i Operacioneve të Fluturimit
FSF	Fondacioni për Siguri Ajrore
MU	Material Udhëzues
IATA	Asociacioni Ndërkombëtar i Transportit Ajror
ICAO	Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil
IEM	Material Interpretues dhe Shpjegues
INFO	Informata
LEP	Lista e faqeve efektive
LOR	Ditari i Rishikimeve
MEL	Lista e Pajisjeve Minimale
MLR	Manualet, Ditarët dhe Regjistrat
NAT PCO	Zyra Koordinuese e Programit të Atlantikut Verior
OD	Direktivat Operative
OM	Manuali i Operacioneve
OPS	Operacioni/Operacionet
ORO	Kërkesat Organizative për Operacionet Ajrore
PM	Menaxher i Projektit
PRA	Rishikimi/Ndryshimi i Propozuar
RNAV	Navigacioni i Hapësirës
RVSM	Minimumi i Zvogëluar i Ndarjes Vertikale
VFR	Rregullat Vizuale të Fluturimit

1. Importi i një aeroplani

Kërkesa për import të një aeroplani (ose marrje përsipër nga një bartës tjetër kosovar i COA-së) mund të ndahet në dy kategori:

- (a) duhet të jetë aeroplani i parë i këtij lloji që fillon operimin në kuadër të COA-së aktuale.
- (b) tipi i aeroplanit është në dispozicion tashmë në COA-në e aplikuesit.

Ngarkesa e punës për aplikuesit dhe AAC-në do të jetë e ndryshueshme. Në rastet e kategorisë (a), nevojiten rishikime të sistemit të manualit (OM-A, OM-C dhe OM-D), si dhe nxjerrja e re e OM-B dhe MEL. Në rastet e kategorisë (b) mjafton rishikimi i sistemit të manualit.

Aplikacioni për një aeroplan të ri duhet të shoqërohet me formularët, aplikacionet, certifikatat dhe rishikimet në vijim

- ☐ AACK/DSF/OPS-FRM 33;
- ☐ Formulari i aplikimit për specifikacionet e operimit (p.sh. RVSM, RNAV, AWO, etj.);
- ☐ Certifikata e sigurimit për përgjegjësinë ligjore për udhëtarët;
- ☐ Kontrata e qirasë ose menaxhimit me përmbytjen në vijim;
 - Aeroplani është i destinuar për përdorim komercial;
 - Periudha e qirasë për të paktën 6 muaj;
 - Qiramarrësi (aplikuesi) është përgjegjës për ekuipazhin dhe mirëmbajtjen;
- ☐ Nxjerra e re ose rishikimet e sistemit të manualit me formularin Rishikimi/Ndryshimi i Propozuar (RNP) që përfshin listën e ndryshimeve;
- ☐ “Lista e filtruar e pajtueshmërisë me COA-në për secilin manual me paragrafët përkatës (mund të gjendet në ueb-faqen e AAC-së);
- ☐ Aplikacioni për pronësi të huaj nëse vlen (sipas shembullit në Shtojcën 1);
- ☐ Manualët e ofruar nga prodhuesi (p.sh. AFM, FOM, etj.);
- ☐ Aplikacioni për Miratim të Përdoruesit;
- ☐ Për aeroplanët e parë në flotë të atij tipi duhet të dorëzohet edhe koncepti i trajnimit;

AAC-ja do të fillojë shqyrtimin sapo të dorëzohen të gjitha dokumentet e nevojshme për aplikim.

2. Eksporti i një aeroplani

Për eksportin e një aeroplani duhet të njoftohet AAC-ja sa më shpejt të jetë e mundur me dorëzimin e formularit **AACK/DSF/OPS-FRM 33**. Pasi aeroplani të hiqet nga COA-ja, aplikuesi duhet të rishikojë sistemin e manualit për rishikime të mundshme. Paragrafi 4 më poshtë përshkruan si të vazhdohet me një rishikim të sistemit të manualit.

3. Ndryshimet në personelin menaxhues

Ndryshimet e personelit menaxhues kanë ndikim serioz për një bartës të COA-së. Pas pranimit të personit të nominuar nga AAC-ja, bartësi i COA-së duhet të dorëzojë një rishikim të paragrafit 1.2 të OM-A sipas Rregullores së AAC-së nr. 01/2019, AMC3 ORO.MLR.100 dhe ndoshta edhe një rishikim të OM-D. Për një aplikim të plotë për ndryshimin e personelit menaxhues sipas ORO.AOC.135, duhet të dorëzohen formularët dhe dokumentet e mëposhtme:

- ☐ AACK/DSF/OPS-FRM 33;
- ☐ Formulari katër i EASA-së;
- ☐ Rezymeja e personit të ri të nominuar (duke përfshirë adresën private të aplikuesit);

Aplikacionet jo të plota ose të gabuara do t'i kthehen aplikuesit.

4. Rishikimi ose nxjerrja e sistemit të ri të manualit

Nxjerrja e re e një manuali ose sistemi të manualit nënkupton që çdo paragraf i manualit do të kontrollohet nga një inspektor i AAC-së. Ndërsa rishikimi nënkupton që vetëm ndryshimet kontrollohen se a janë në pajtim me rregullat dhe rregulloret.

Rishikimi ose nxjerrja e re duhet të dorëzohen në AAC me formularët dhe manualët në vijim:

- ☐ Nxjerrja e re ose rishikimet e sistemit të manualit me formularin Rishikimi/Ndryshimi i Propozuar (RNP) që përfshin listën e ndryshimeve;
- ☐ “Lista e filtruar e pajtueshmërisë me COA-në për secilin manual me paragrafët përkatës (mund të gjendet në ueb-faqen e AAC-së);
- ☐ Manualët e ofruar nga prodhuesi (p.sh. AFM, FOM, etj.) në rast se preket OM-B.

5. Ndryshimi i emrit të operatorit

Ndryshimi i emrit të operatorit do të ndikojë në të gjitha certifikatat. Prandaj, duhet të dorëzohen formularët dhe dokumentet në vijim:

- ☐ Formulari AACK/DSF/OPS-FRM 33;
- ☐ Formulari AACK/DSF/OPS-FRM 34 (për konfirmimin e karakterit kosovar të operatorit ajror)
- ☐ Kopja e certifikuar nga regjistri tregtar

6. Ndryshimi i pronësisë së një aeroplani

Për arsye të ndryshme një bartës i COA-së mund të dëshirojë ose të detyrohet të ndryshojë pronarin e një aeroplani, gjë që çon në ndryshime në regjistrin e avionëve të Kosovës. Nëse selia e pronarit të ri ndodhet jashtë Kosovës, qiramarrësi (aplikuesi) duhet të dorëzojë një aplikacion me shkrim për pronësi të huaj në AAC me dokumentet në vijim:

- ☐ Formulari AACK/DSF/OPS-FRM 33;
- ☐ Kontrata e qiramarrjes ose menaxhimit me deklaratat në vijim:
 - Aeroplani është i destinuar për përdorim komercial,
 - Periudha e qiramarrjes është të paktën 6 muaj,
 - Qiramarrësi (aplikuesi) është përgjegjës për ekuipazhin dhe mirëmbajtjen.
- ☐ Ose një lloj novacioni nëse marrëveshja ekzistuese e qiramarrjes mbetet në fuqi
- ☐ Aplikacioni për pronësi të huaj (sipas shembullit në Shtojcën 1)

7. Ndryshimi i specifikacioneve operative të flotës së aeroplanëve

Një bartës i COA-së mund të dëshirojë t'i shtojë specifikacione të reja operative një aeroplani ose flote aeroplanësh. Aplikacioni për këtë duhet të dorëzohet me formularët dhe dokumentet në vijim:

- ☐ Formulari AACK/DSF/OPS-FRM 33;
- ☐ Formulari i aplikimit për specifikacionet operative (p.sh. RVSM, RNAV, AWO, etj.);
- ☐ Nxjerra e re ose rishikimet e sistemit të manualit me formularin Rishikimi/Ndryshimi i Propozuar (RNP) që përfshin listën e ndryshimeve;
- ☐ “Lista e filtruar e pajtueshmërisë me COA-në për secilin manual me paragrafët përkatës (mund të gjendet në ueb-faqen e AAC-së);
- ☐ Manualët e ofruar nga prodhuesi (p.sh. AFM, FOM, etj.);
- ☐ Duhet të plotësohen aspektet e trajnimit.

8. Kostot dhe afatet kohore

Kostot dhe afatet kohore janë shumë individuale dhe mund të ndryshojnë në varësi të cilësisë së parashtresave dhe burimeve të disponueshme në AAC. AAC-ja do të ngarkojë dhe shqiptojë tarifa në përputhje me dispozitat e Rregullores nr. 2/2015 të AAC-së për Tarifat e Ngarkuara nga Autoriteti i Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës. Zbatimi i afateve kohore do të jetë në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi

9. Shtojcat

Shtojca 1 – Shembull i aplikacionit për pronësi të huaj

Për aplikimin e një bartësi të COA-së të Kosovës për të regjistruar një aeroplan me pronësi të huaj në regjistrin e Kosovës sipas nenit 40 paragrafi 2 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, mund të përdoret shablloni në vijim:

Zotërinj të nderuar,

Ne aplikojmë për leje sipas nenit 40 paragrafi 2 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil (LCA) për regjistrimin në regjistrin e Kosovës të aeroplanëve në vijim me pronësi të huaj për përdorim komercial në kuadër të COA-së sonë (XYZ):

Aeroplani: *Prodhuesi, tipi/ modeli i aeroplanit
s/n 8888
Regjistrimi i rezervuar: XX-YYYY
Data e propozuar e regjistrimit: Dita-Muaji-Viti*

Pronari: *Kompania XYZ Holding Inc.
Selia
Rruga
Kodi postal
Qyteti
Shteti*

Bartësi i COA-së: *XYZ Airlines
Adresa
Kodi postal
Qyteti*

Ju falënderojmë për përgjigje pozitive brenda afatit.

Juaji singerisht

*XYZ Airlines
Emri, mbiemri
Personeli përgjegjës për menaxhim sipas Kapitulli 13 të OM-A (Qiramarrje)*

Bashkëngjitjet:

- ✓ *Formulari AACK/DSF/OPS-FRM 33*
- ✓ *Marrëveshja e Qirasë ose Menaxhimit*
- ✓ *Ekstrakti nga oda ekonomike që përfaqëson kompaninë XYZ Holding Inc.*
- ✓ *Certifikatat e sigurimit të përgjegjësisë ligjore të palës së tretë dhe sigurimit të përgjegjësisë ligjore të udhëtarëve*

Shtojca 2 – Adresa të ueb-faqeve/vegëza të dobishme

AEA	http://www.aea.be/AEAWebsite/Presentation_Tier/Pr_Home.aspx
ATA	http://www.air-transport.org/
EASA	http://www.easa.eu.int/home/index.html
ECAC	http://www.ecac-ceac.org/index.php
EUR Lex	http://eur-lex.europa.eu/de/index.htm (rregullat dhe marrëveshjet)
EUROCONTROL	http://www.eurocontrol.be/corporate/public/subsite_homepage/index.html
CAAK	https://caa.rks-gov.net/en/
FSF	http://www.flightsafety.org/home.html
IATA	http://www.iata.org/index.asp
ICAO	http://www.icao.int/
IHS	http://www.ihs.com/
NAT PCO	http://www.nat-pco.org/index.htm